



NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A.
PUBLIC HOUSING ENTERPRISE J.S.C.

Adr: Rr. Bill Clinton pn. Prishtinë-Kosovë
Tel: +381(0)38 553 311/523 001; Fax: +381 (0)38 522 446
e-mail: npb@npbanesore.com web: www.npbanesore.com

Nr. i Protokollit: _____ Data: _____

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A Prishtinë, shpall:

K O N K U R S

Për zgjedhjen e pesëmbëdhjetë (15) Asfaltuesve në Departamentin e Intervenimeve Emergjente, në Ndërmarrjen Publike Banesore –SH.A me seli në Prishtinë.

Detyrat dhe përgjegjësitë specifike

- Kryen punët e Departamentit të Intervenimeve Emergjente në operimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore që kërkohen nga udhëheqësi i Njesisë për Intervenime si dhe udhëheqësi i Divizionit;
- Është përgjegjës për të gjitha punimet të cilat i kryen grupi;
- Është përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjithë procesit të punës së grupit;
- Bën: Evidentimin e gropave në rrugë dhe trotuare, prerjen dhe pastrimin e gropave, spërkatjen me emulsion të gropave, mbushjen me asfalt, ngjeshjen e asfaltit, rrafshimin e rrugëve dhe trotuareve me zhavor, shtrimin e kubave, pllakave, vendosjen e anësoreve prej betonit, shënjimin vertikal dhe horizontal të rrugëve, mirëmbajtjen e shenjave të komunikacionit etj.
- Mbanë përgjegjësi për materialin e shpenzuar si dhe shpenzimet e materialit i shënon në dëshmitë përkatëse sipas dokumentacionit të NPB për punët të cilat i kryen;
- Raporton për punët e kryera te kryepunëtori i grupit dhe udhëheqësi i njesisë;

Raportimet

- Bartësi i vendit të punës i raporton kryepunëtorit të grupit

Kualifikimet

- Shkolla e mesme profesionale
- Bartësi i vendit të punës duhet të ketë së paku 1 vjet përvojë pune .

Kualifikimet tjera

- Njohja e teknikave bazë të shtrimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve.
- Aftësi për të përshtatur me kushte të punës
- Aftësia për të përmbushur projekte.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën ***Asfaltues në Departamentin e Intervenimeve Emergjente*** duhet t'i dorëzoi këto dëshmi:

- CV-në;
- Dëshminë e Shkollimit;
- Dëshminë për Përvojën e Punës;
- Kopjen e Lejes së Njoftimit; dhe
- Referenca të tjera që janë të rëndësishme për këtë vend pune.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: **Ndërmarrja Publike Banesore - SHA në Prishtinë, rruga “Xhevdet Doda”,nr.32, Prishtinë** ose përmes e-mailit zyrtar: burimet.njerezore@npbanesore.com.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen. **Konkursi është i hapur nga data 22 Qershor 2019 – 07 Korrik 2019 ora 16:00.**